

VENDIM
Nr. 349, datë 7.6.2023

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË
SHOQËRISË “TRAJTIMI I STUDENTËVE” SHA, VLORË, NGA MINISTRIA E
FINANCave DHE EKONOMISË TEK BASHKIA VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Vlorë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Vlorë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku